

NJOFTIM PUNE

BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Spar Albania sh.p.k. është pjesë e Balfin Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit "SPAR".

Pozicioni: Trajnues/e

Departamenti: Fresh

Vendodhja: Tiranë

Detyra dhe Përgjegjësi:

- Trajnon stafin e shitjes së departamenteve të freskëta mbi rregullat dhe procedurat e kompanisë.
- Kryen seanca trajnimesh periodike për procese të paracaktuara pune.
- Ndjek trajnimet në pikat e shitjes dhe analizon feedbackun nga trajnimet e kryera.
- Mban rekorde për ndjekjen e trajnimeve dhe harton plane afatshkurtra dhe afatmesme mbi zhvillimin e tyre.

Kërkesat:**a. Edukimi:**

- Të ketë kryer studimet e larta.

b. Eksperiencat e punës: Minimumi 1 vit eksperiencë pune si Trajnues/e ose eksperiencë e ngjashme në market në Departamentin e Fresh-it.

c. Kualifikime të tjera:

- Njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- Aftësi shumë të mira shpjeguese dhe trajnuese.
- Preferohet të njohë produktet dhe punën në market.

d. Aftësi të tjera:

- Të jetë i/e motivuar dhe i/e fokusuar në arritjen e objektivave të vendosura.
- I/e organizuar dhe manaxhues/e i/e mirë e kohës.

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin ose nëpërmjet postës në adresën: Spar Albania, Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 07/06/2022

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrotjen e të Dhënave Personale".*